

Në përputhje me Ligjin për Qytetin e Shkupit, dhe në drejtim të implementimit të aktiviteteve të parashikuara me Programin për aktivitetet nga fusha e mbrojtjes sociale, fëmijëve dhe shëndetësore, në qytetin e Shkupit, për vitin 2018, të miratuar në seancën e 4-të të Këshillit të Qytetit të Shkupit, të mbajtur më 27.12.2017, dhe në bazë të kriterëve dhe prioritetëve të dhëna në këtë thirrje:

**QYTETI I SHKUPIT**  
**Shpall**  
**Tirrje publike për**

**I. LOGJISTIKË, ORGANIZIM DHE PROMOCION I MBRËMJEVE TË TË DREJTAVE TË GRAVE 2018**

Shpërndarja e mjeteve të Buxhetit të Qytetit të Shkupit për vitin 2018, të destinuar për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave civile dhe fondacioneve, do të kryhet në bazë të Programit për aktivitetet në fushën e mbrojtjes sociale, fëmijëve dhe shëndetësore, në qytetin e Shkupit, për vitin 2018.

**PËRSHKRIMI I SHKURTËR**

Evenimenti “Mbrëmjet e të drejtave të grave 2018”, organizohet me rastin e Ditës ndërkombëtare të gruas, 8-të Marsi, dhe ka për qëllim që të ofrojë një alternativë kulturore për kremtimin e kësaj date të rëndësishme për avancimin e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore. Nëpërmjet artit, evenimenti nxit femrat dhe meshkujt, që në mënyrë kritike të sillen ndaj pabarazive gjinore, duke vënë një theks të veçantë në arritjet e deritanishme në këtë fushë.

Në edicionin e nëntë të “Mbrëmjet e të drejtave të grave” do të projektohen filma dokumentarë të prodhimit më të ri botëror, të përcjella me diskutime tematike dhe evenimente përcjellëse.

**Qëllimet e mbrëmjeve për të drejtat e grave**

- Të ngrihet vetëdija për gjendjen e të drejtave të grave;
- Të iniciohet debat për barazi gjinore në kontekst të kulturës dhe artit nëpërmjet shprehjes kreative;
- Të promovohet qasja dokumentare si një mjet i dobishëm gjatë diskutimeve lidhur me çështjet e gjinive;
- Të përkrahet dhe promovohet aktivizimi rinor në avancimin e statutit të grave dhe barazisë gjinore;
- Të ofrohet alternativa kulturore gjatë kremtimit të Ditës ndërkombëtare të gruas, 8-të Marsi.

**Përmbajtje të përcaktuara**

- Projektimi i filmave dokumentarë, që do të fokusohen në çështjet e lidhura me barazinë gjinore dhe fuqizimin e pozitës së gruas;
- Diskutime tematike në lidhje me projektimet filmike, me mysafirë relevantë nga fusha përkatëse, ekspertë dhe opinioni i gjerë;
- Evenimenti përfundimtar për mbylljen e manifestimit;
- Organizimi i evenimenteve përcjellëse ( debate, ekspozitë, forume me nxënës të shkollave të mesme etj.);
- Promovimi mediatik i evenimentit;

## **Detyrat e punës**

- Organizimi teknik i projeksioneve;
- Drejtimi i diskutimeve tematike në lidhje me projektimet filmike;
- Logjistika e aktiviteteve dhe përcjellja e avancimit të realizimit të tyre;
- Sigurimi i hapësirës për organizimin e evenimentit dhe pajisje adekuate teknike për shfaqjen e filmave dhe zhvillimin e diskutimeve me mundësi për ndjekjen e filmit dhe diskutimeve me përkthim;
- Seleksionimi i filmave në përputhje me temën e edicionit të tetë të Mbrëmjeve, prezantimi i tyre me partnerët e evenimentit;
- Sigurimi i të drejtave autoriale dhe kompensimeve;
- Përkthimi i filmave dokumentarë në gjuhën maqedonase dhe angleze;
- Sigurimi i moderatorit zyrtar të evenimentit;
- Botimi i materialeve promovuese (posterë, fletëpalosje, emblema, bluza etj.) dhe shpërndarja e tyre;
- Organizimi i ekspozitës për temën e caktuar të evenimentit;
- Organizimi i forumeve dhe debateve në shkollat e mesme;
- Organizimi i evenimentit përfundimtar;
- Koordinimi i partnerëve të përfshirë në eveniment, studentëve dhe vullnetarëve;

## **Korniza kohore dhe mënyra e shfrytëzimit të mjeteve**

Mbrëmjet e të drejtave të grave do të përfshijnë 10 projeksione në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit, të cilat do të organizohen gjatë vitit shkollor, dhe me rastin e Ditës ndërkombëtare të gruas, 8-të Marsi.

Me nënshkrimin e Kontratës do të specifikohet edhe mënyra e shfrytëzimit të mjeteve.

## **Korniza kohore dhe mënyra e shfrytëzimit të mjeteve**

Me nënshkrimin e Kontratës do të specifikohet mënyra e shfrytëzimit të mjeteve.

## **III. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM**

- Fletëparaqitje për përkrahjen financiare të Organizatës (e plotësuar me shkronja shtypi në alfabetin cirilik, të nënshkruar nga përfaqësuesi i Organizatës dhe e vërtetuar me vulën e Organizatës) ([www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk));
- Formular i plotësuar në kompjuter për Propozim-Projektin me aktivitet e përgatitura në mënyrë të hollësishme për aktivitetet kryesore dhe përcjellëse, ([www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk));
- Statuti i Organizatës;
- Fotokopje e vendimit për regjistrimin e Organizatës;
- Raport për mjetet e marra nga Buxheti i Qytetit të Shkupit në vitin e kaluar fiskal dhe mënyra e realizimit të tyre (nëse organizata ka qenë përfitues i mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2017);
- Raport vjetor i Organizatës për vitin 2016 dhe/ose 2017;
- Fotokopje nga llogaria përfundimtare për vitin 2016;
- Vërtetim për tatime të paguara të lëshuar nga organet tatimore.

## **Dokumentacioni përcjellës**

Organizatata si shtojcë duhet të deponojnë edhe këtë dokumentacion përcjellës:

- Biografi personale e personave profesionalë që do të angazhohen në realizimin e projektit,
- Listë referuese ose dëshmi (për shembull: kontratë e nënshkruar) për më së paku 2 projekte të realizuara në fushën për të cilën aplikohet,
- Më së paku dy mendime/referenca nga partnerë ose donatorë për realizimin e projekteve të mëparshme, dhe
- Përkrahje me shkrim nga organizata të tjera ose institucione për të cilat është planifikuar të marrin pjesë në realizimin e projektit.

Vlerësimi i fletëparaqitjeve të arritura, do të bëhet nga Komisioni i formuar nga Kryetari i Qytetit të Shkupit, në bazë të këtyre kriterëve;

<b>KRITERET PËR VLERËSIM</b>	<b>PIKËT MAKSIMALE</b>
<b>1. Struktura organizative dhe resurset</b>	<b>50</b>
1.1. Kapaciteti i Organizatës në lidhje me resurset njerëzore për realizimin e evenimentit (të punësuar, vullnetarët aktiv, personat e angazhuar me honorar, përfaqësim i balancuar i grave dhe burrave në organizatë)	10
1.2. Përvoja dhe profesionalizmi i personave të cilët marrin pjesë në realizimin e projektit	10
1.3. Përvoja e Organizatës në organizimin e evenimenteve me volum të tillë në fushën adekuate	10
1.4. Kapaciteti teknik i nevojshëm për realizimin e projektit	10
1.5. Partneritetet e vendosura dhe përfshirja e institucioneve tjera relevante për temën,	10
<b>2. Kualiteti i projektit</b>	<b>50</b>
2.1. Harmonizimi i aktiviteteve të propozuara / përcjellëse me qëllimet e thirrjes / programit/ strategjisë	10
2.2. Ofrimi i zgjidhjeve kualitative dhe inovative për realizimin e detyrave të punës	10
2.3. Aktivitete të përgatitura në mënyrë të hollësishme	10
2.4. Arsytim i shpenzimeve të planit të propozuar financiar (buxhet real në raport me aktivitetet dhe numrin e personave të angazhuar, përshkrimi i shpenzimeve sipas pozicioneve dhe sa ato korrespondojnë me çmimet e tregut)	10
2.5. Pjesëmarrje në fletëparaqitje me mjete financiare të siguruara nga burime personale dhe burime tjera	10
<b>Numri maksimal i pikëve</b>	<b>100</b>

### **E drejta për pjesëmarrje**

Në Thirrjen publike mund të marrin pjesë persona juridikë të regjistruar për kryerjen e veprimtarisë në përputhje me legjislacionin ekzistues në Republikën e Maqedonisë.

### **Afati dhe mënyra e dorëzimit të fletëparaqitjeve**

Afati i fundit për dorëzimin e fletëparaqitjeve është data 09.02.2018 deri në orën 15,00.

Fletëparaqitjet me dokumentacionin e plotë deponohen nëpërmjet postës (fletëparaqitjet e deponuara nëpërmjet e-mailit ose me faks nuk do të shqyrtohen), në adresën: **Qyteti i Shkupit, Seksioni për mbrojtje sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore, bul. "Ilinden" nr 82, 1000**

**Shkup** ose në arkivin e Qytetit të Shkupit (me emërtimin – Seksioni për mbrojtje sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore – Fletëparaqitje për Thirrje publike).

Parashtruesit e fletëparaqitjeve do të informohen për rezultatet në një afat kohor prej 15 ditësh nga dita e sjelles së vendimit për zgjedhjen e ofertuesit më të volitshëm.

**Vërejtje: Fletëparaqitjet që nuk do të përmbajnë dokumentacionin e plotë ose do të deponohen pas skadimit të afatit të parashikuar nuk do të shqyrtohen! Shtojcat e deponuara nuk kthehen.**

Për informata plotësuese:

Pyetje për sqarime mund të parashtrohen me shkrim ose në mënyrë elektronike deri te: Seksioni për mbrojtje sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore.

Kontakt: Seksioni për mbrojtje sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore, tel: 02/ 3297 321; email: [natasam@skopje.gov.mk](mailto:natasam@skopje.gov.mk).

**Qyteti i Shkupit**